



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Peqin, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_, Datë \_\_\_.04.2024

**“PËR MIRATIMIN E SHITJES SË 80% TË AKSIONEVE TË BASHKISË PEQIN NË SHOQËRINË KLUBI I FUTBOLLIT SHKUMBINI SH.A.”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 54, të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, të Ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Peqin;

**PROPOZIM:**

1. Të miratojë shitjen e 80% të aksioneve të Bashkisë Peqin në shoqërinë Klubin e Futbollit Shkumbini Sh.A. Ofertuesit fitues shoqërisë “The Water Co” sh.p.k., me Nr. NIPTI M33029202K.
2. Çmimi i shitjes së 80% të aksioneve, të drejtave dhe detyrimeve të fituara ose që do të fitohen në të ardhmen, që Shitësi zotëron si aksioner në shoqërinë K.F. Shkumbini Sh.A. sipas procedurës së ankandit të publik të zhvilluar më datë 18.3.2024 është 4,100,000 (katërmilionenjëqindmijë) lekë.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Peqin të negociojë me shoqërinë “The Water Co” sh.p.k. dhe të nëshkruajë aktet përkatëse për realizimin e shitjes së aksioneve.
4. Të miratojë dhe njohë si detyrime të Bashkisë Peqin detyrimet financiare të Klubit të Futbollit Shkumbini Sh.A ndaj palëve të treta deri më datë 31.3.2024 në vlerën 38,427,286 lekë.  
Detyrimet financiare të Klubit të Futbollit Shkumbini Sh.A ndaj paleve të treta deri më 31.3.2024 janë të detajuara sipas Lidhjes 1 bashkëlidhur dhe pjesë e këtij projekt-vendimi.
5. Ngarkohet me zbatimin e këtij projekt-vendimi Kryetari Bashkisë, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe TIK, dhe Drejtoria e Finances.
6. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

KRYETARI I BASHKISË

Bukurosh MACI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. \_\_\_\_ .Prot.

Peqin, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROJEKT-KONTRATE PUBLIKE SHITJE**

**“PËR SHITJEN E 80% TË AKSIONEVE TË BASHKISË PEQIN NË KLUBIN E  
FUTBOLLIT SHKUMBINI SH.A”**

Kjo kontratë nënshkruhet sot me datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024, në Bashkinë Peqin ndërmjet dy palëve:

<b>Autoriteti Shitës:</b>	<b>Bashkia Peqin, përfaqësuar nga Kryetari Z.Bukurosh Maçi</b>
<b>Adresa :</b>	<b>Bulevardi “Mustafa Gjinishi” Peqin</b>
<b>Tel/Fax:</b>	_____
<b>NR. NIPTI:</b>	<b>K49701113D</b>
<b>Dhe</b>	
<b>Blerësi:</b>	<b>“The Water Co” sh.p.k.</b>
<b>Adresa :</b>	<b>Fshati Bardhas, Zona Kadastarë Nr .1112 Nr. Pasurie 19/18- ND, Peqin, Shqipëri</b>
<b>NR. NIPTI:</b>	<b>M33029202K</b>
<b>Përfaqësues ligjor :</b>	<b>Ali Kasa</b>

**KREU I : KUSHTE TE VEÇANTA**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

**Neni 1: Baza ligjore**

Kontrata mbështetet në :

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - Ligjin Nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar, neni 6.
  - Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. i ndryshuar.
  - Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar.
  - Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”. i ndryshuar, Kreu V, pika 5.
  - Urdhrit e Kryetarit të Bashkisë Peqin Nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_2.2024 “Për fillimin e procedurës së ankandit me objekt “Shitjen e 80% të aksioneve të zotëruara nga Bashkia Peqin në Klubin e Futbollit Shkumbini Sh.A”
- Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2: Perberja e kontratës**

Kontrata do të perbehet nga dokumentat e ankandit publik të zhvilluar me datë **18.03.2024** duke përfshirë KPK dhe KVK si dhe nga formularët si më poshtë:

- Formulari i kontrates i nënshkruar nga palet me dokumentat e tenderit të cilesuara në të.
- Formulari i Sigurimit të kontrates në shumën 10% të vlerës së kontrates në formë garancie të leshuar nga Shoqëria e Sigurimit “\_\_\_\_\_” sh.a.

### **Neni 3: Objekti i kontratës**

Shitje e 80% (tetëdhjetëpërqind) të aksioneve të zotëruara nga Autoriteti Shitës Bashkia Peqin në Klubin e Futbollit Shkumbini Sh.A. kundrejt ofertuesit fitues (Blerësit “The Water Co sh.p.k.”) dhe të drejtave dhe detyrimeve të fituara ose që do të fitohen në të ardhmen, që Shitësi zotëron si aksioner në shoqërinë Klub Futboll Shkumbini Sh.A.

### **Neni 4: Informacion mbi palët dhe objektin e kontratës:**

Bashkia Peqin është zotëruese e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare Klub Futboll Shkumbini Sh.A., me Nr. NIPTI L19505101P.

Këshilli i Bashkisë Peqin, me Vendimin Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_.2024 “” ka dhënë miratimin për shitjen me ankand të 80% të aksioneve të Klub Futboll Shkumbini Sh.A.

Autoriteti Shitës, më datë \_\_\_\_.2024 shpalli fitues të procedurës së ankandit publik me objekt “Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Shkumbini” Sh.A në masë 80% të zotëruara nga Bashkia Peqin” me cmimin 4,100,000 (katërmilionnjëqindmijë) lekë si ofertë e kualifikuar me cmimin më të lartë të ofruar, ofertën e subjektit “The Water Co” sh.p.k. me Nr. NIPTI M33029202K.

Me ekzekutimin e kontratës së blerjes së aksioneve të Bashkisë Peqin në shoqërinë aksionare K.F. Shkumbini Sh.A., shoqëria “The Water Co” sh.p.k. do të zotërojë 80% (tetëdhjetëpërqind) të aksioneve të shoqërisë Klub Futboll Shkumbini Sh.A.

### **Neni 5: Përkufizime**

5.1 “kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit shites dhe ofertuesit fitues që përbëhet nga Dokumentat e ankandit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

5.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet autoritetit shites sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

5.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Autoriteti shites tek Ofertuesi fitues.

5.4 “Lëvrimi ” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

5.5 “Autoriteti shites” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.

5.6 “Ofertues fitues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat.

5.7 “palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

5.8 “Aksione” do të thotë ndarje e kapitalit të shoqërisë dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen në zotërimin e tyre.



5.9 “Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose te paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

5.10 “objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Autoriteti shites do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

5.11 “Standarte Teknike” do të thote specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

#### **Neni 6: Cmimi i shitjes**

Çmimi i shitjes së 80% të aksioneve, të drejtave dhe detyrimeve të fituara ose që do të fitohen në të ardhme, që Shitësi zotëron si aksioner në shoqërinë K.F. Shkumbini Sh.A. sipas procedurës së ankandit është 4,100,000 (katërmilionenjëqindmijë) lekë.

Çmimi i kontrates është fiks i pandryshueshem. Në çmim përfshihen të gjitha detyrimet për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 7: Sigurimi i kontrates**

Garancia e kontrates e paraqitur nga kontraktuesi para lidhjes së kontrates sipas modelit përket dhe në dokumentat e ankandit kap vlerën **10%** të vlerës së kontrates ose në vlerë absolute **410,000 (katërqinddhjetëmijë) lekë**. Kjo shumë do të garantojë Autoritetin Shitës për përmblyshjen e detyrimeve kontraktuale nga Blerësi.

Çlirimi i garancisë së kontrates (**10%**) do të bëhet me shkrim nga Autoriteti Shitës, 30 ditë pas përmblyshjes së detyrimeve kontraktuale nga Blerësi.

#### **Neni 8: Informacion mbi burimin e të ardhurave**

Sipas deklarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë Autoritetit Shitës rezultojnë se të ardhurat e ofertuesit fitues, për pagesën e çmimit të kësaj kontrate janë si rezultat i biznesit që ky ofertues ka në mënyrë të ligjshme.

#### **Neni 9: Transferimi i pronësisë**

Aksionet e shitura nga Autoriteti Shitës si aksioner në shoqërinë K.F. Shkumbini sh.a. dhe cdo e drejtë dhe detyrim që buron prej këtyre aksioneve, i kalojnë/transferohen në pronësi të ofertuesit fitues (Blerësit) brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët dhe me kushtin që nga ana e blerësit të jetë bërë pagesa e plotë e çmimit të kontratës.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët dhe pagesën e plotë të çmimit të kontrates, autoriteti shites humbet pronësinë dhe nuk do të jetë me zotues, pronar i aksioneve të shitura tek ofertuesi fitues, duke deklaruar se nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim lidhur me këto.

Pala blerëse me nënshkrimin e kontrates nga palët dhe pagesën e plotë të çmimit të kontrates fiton pronësinë e aksioneve me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentin të shitjes së kuotës së aksioneve dhe do të lindin në vazhdim si pasoje e zotërimit të këtyre kuotave, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore (TVSH, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim, taksat dhe tarifatat vendore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, gjokat dhe kamatëvonesat, faturime të FSHU dhe UKP, etj.), ndaj të treta, shoqërive tregtare dhe personave fizik (cdo e drejtë/detyrim i cili rrjedh nga kontrate qiraje, shërbimi, emfiteoze, leasing, kredi, huaje etj.) apo cdo e drejtë/detyrim ndaj shoqërive

shendetesore, gjobat dhe kamatevonesat, faturime te FSHU dhe UKP, etj.), ndaj të tretteve, shoqerive tregtare dhe personave fizik (cdo e drejte/detyrim i cili rrjedh nga kontrate qiraje, sherbimi, emfiteoze, leasing, kredi, huaje etj.) apo cdo e drejte/detyrim ndaj shoqerive tregtare dhe/ose organizatave joqeveritare qe shoqeria K.F. Shkumbini sh.a. perfshire cdo te drejte/detyrim i/e cila nuk eshte permendur shprehimisht ne kete kontrate dhe ne menyre ligjore ose/dhe kontraktuale i takon bleresit.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate nga palet dhe pagesen e plote te cmimit te kontrates nga ofertuesi fitues, administratori i shoqerise K.F. Shkumbini sh.a. detyrohet menjehere te kryeje te gjitha procedurat ligjore per regjistrimin e kesaj kontrate ne QKB per ndryshimin e pronesise mbi aksionet.

**Afati:** Palet kane rene dakort qe afati per likuidimin e cmimit te shitjes do te jete brenda 30 diteve nga nenshkrimi i kesaj kontrate.

**Menyra e pageses:** Bleresi brenda 30 diteve nga nenshkrimi i kesaj kontrate duhet qe te transferoje me nje kest vleren e cmimit te kesaj kontrate prej 4,100,000 (katermilionenjqindmije) leke ne llogarine e Autoritetit Shites, me koordinatat e percaktuara ne faturen per arketim te leshuar nga Autoriteti Shites si me poshte;

Dega e Thesarit Peqin

Kodi i të Ardhurave 166300 "Shitja e Titujve te pjesemarrjes ne Shoqerite e Perbashketa".

Perfituesi: Bashkia Peqin

#### **Neni 10: Kushtet dhe Afatet e Pagesës**

Palët kane rene dakort qe afati per likuidimin e shitjes do te jete me nje kest, brenda 30 diteve nga nenshkrimi nga palet i kesaj kontrate.

Cmimi i kontrates duke perfshire cdo pagese paraprake, duhet te paguhet ne kohe sic specifikohet ne kontrate. Pagesa duhet bere ne monedhe Shqiptare. Kursi i shkembimit i monedhave te ndryshme do te jete kursi i Bankes se Shqiperise i fiksuar ne ditën e dergimit per botimin te njoftimit te kontrates.

Date pagese do te konsiderohet dita qe fondet xhirohen ne llogarine e Autoritetit Shites.

#### **Neni 11: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumëve totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin te provoje ndonje dem. Nëse kreditori provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

#### **Neni 12: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

Ofertuesi fitues duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Autoriteti shites do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

Autoriteti shites mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se ofertuesi fitues ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Ofertuesi fitues duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin shites me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar per marrjen ne dorezim. Autoriteti shites duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti shites është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga te dy palet.



Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.  
Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 14: Llogaritja e Afateve**

34.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Neni 15 Përfundimi i kontrates**

Kjo kontrate perfundon kur:

Palet kane permbushur detyrimin sipas kushteve dhe afateve te pershkruara.

Ofertuesi fitues deshton te zbatoje ndonje detyrim tjetër te kontrates sipas kushteve dhe afatit te percaktuar. Ne kete rast Autoriteti Shites duhet t'i jape Ofertuesit fitues njoftim me shkrim per nderprerjen per mosplotesim dhe ti jape ofertuesit 15 dite te ndreqe mosplotesimin me perjashtim kur nderprerja eshte bere per veprime korruptive ose te paligjshme, rast ne te cilin nderprerja do te jete e menjehershme.

Ofertuesi fitues falimenton ose behet i paafte te paguaje. Ne kete rast Autoriteti shites duhet t'i jape ofertuesit fitues njoftim me shkrim per nderprerjen.

**Neni 16: Baza Ligjore**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 17: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

Palet duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 18: Gjuha e kontrates dhe hyrjen ne fuqi.**

Kjo kontrate u redaktua ne gjuhen shqipe ne 5(pesë) faqe. Palet pasi e lexuan dhe kuptuan permbajtjen e dispozitave te kesaj kontrate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ne 4 (kater) kopje te njejta.

Kontrata hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj prej paleve.

**PER AUTORITETIN SHITES**

**PER PALEN BLERESE**

**BASHKIA PEQIN**

**SUBJEKTI "THE WATER CO" sh.p.k.**

**KRYETARI I BASHKISE**

**ADMINISTRATORI**

**/ Bukurosh MAÇI /**

**/ Ali KASA /**